



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KORÇË**

**VENDIM**

Nr 91 Datë 18.10.2010

**PER**

**Miratim fondi për organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare nga  
Universiteti "F.S.Noli" Korçë**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, me propozim të komisionit të financës dhe të këshilltarëve të Këshillit Bashkiak, bazuar në materialin mbi organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare « Jug-Lindja Shqiptare për mundësitë dhe sfidat e Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt procesit të Integritimit » nga ana e Universitetit F.S.Noli, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» ligjin nr. 10190 dt. 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010», Udhëzimin nr.1 dt.21.01.2010 M.F «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010», V.K.B nr. 20 dt. 25.03.2010 « Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010», dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:


**VENDOSI**

1. Të miratoje fondin prej 300,000 lekësh për organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare « Jug-Lindja Shqiptare për mundësitë dhe sfidat e Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt procesit të Integritimit » .
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i shpenzimeve operative të Bashkisë (kësti i kredisë) me këtë strukturë buxhetore :

PAKESOHET	00	01110	05	Art 6020000	-	300,000 leke
SHTOHET	00	01110	05	Art 6040000	+	300.000 leke

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës si dhe Universiteti Fan S Noli.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



**Kryetari**

**GJERGJI PENDAVINJI**